



VENDIM

Nr. 13, Datë 19.01.2017

**PËR
LIÇENSIM E SHOQËRISË “MC INERTE LUMZI” SH.P.K, NË
AKTIVITETIN E TREGËTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, gërma ”d” të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 5, gërma “e”; 13 dhe 21 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr. 109, datë 29.06.2016 dhe nenit 15 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin Nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 19.01.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licensimin e shoqërisë “MC INERTE LUMZI” sh.p.k, në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike, përgatitur nga Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut,

Konstatohet se:

Aplikimi i shoqërisë “MC INERTE LUMZI” sh.p.k, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/10 gërmat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licensojë shoqërinë “MC INERTE LUMZI” sh.p.k, në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike, për një afat 5 vjecar.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE
Petrit AHMETI